



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO	
MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIE-MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE-MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY	
Nr. Prot. Org. Jedinica Org. Unit	01
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	2474
Nr. I faqeve Broj stranica No. pages	3
Data. Datum. Date:	31.05/20 20

Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike
Ministarstvo Ekonomije, Zapošljavanja, Trgovine, Industrije, Preduzetništva i Strateških Investicija
Ministry of Economy, Employment, Trade, Industry, Entrepreneurship and Strategic Investments

Nr. 01/11

Prishtinë, 31.05.2020

Ministrja e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, mbështetur në nenin 11 të Ligjit 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, në nenin 8.1.4 dhe pikat 20, 30 e 31 të shtojcës 7 të Rregullores së Qeverisë 05/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive dhe në vendimet e Qeverisë 01/09 të 13 marsit 2020, 1/11 të 15 marsit 2020, 01/24 të 8 prillit 2020 dhe 02/38 të 31 majit 2020, si dhe duke marrë parasysh vendimet dhe udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë, urdhëresat MEPTINIS 01/01 të 12 marsit 2020, 01/02 dhe 01/03 të 17 marsit 2020, 01/04 të 20 marsit 2020, 01/05 të 23 marsit 2020, 01/07 të 12 prillit 2020, 01/08 të 18 majit 2020 dhe rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike me qëllim të luftimit dhe parandalimit të pandemisë COVID-19, nxjerr këtë:

URDHËRESË
për mbarëvajtjen e veprimtarive ekonomike
gjatë emergjencës së shëndetit publik

1. Lejohen të operojnë edhe:
 - 1.1. qendrat tregtare me mjedise të mbyllura; dhe
 - 1.2. lokalet e gastronomisë, duke përfshirë kafeteritë, baret dhe restorantet.
2. Nuk lejohen:
 - 2.1. klubet e natës;
 - 2.2. organizimi i ahengjeve dhe dasmave në salla dasme ose objekte të tjera; dhe
 - 2.3. veprimtari të tjera të ngjashme.
3. Operatori përgjegjës për qendrën tregtare duhet të marrë këto masa:
 - 3.1. të sigurojë se nuk do të ketë tollovi në hapësira të përbashkëta dhe në hyrje të qendrës tregtare ose të lokaleve, duke kufizuar numrin e njerëzve që hyjnë në qendër tregtare, duke shpërndarë turmat dhe duke marrë masa të tjera të nevojshme;



- 3.2. të dezinfektojnë hapësirat e përbashkëta të qendrës tregtare dhe të sigurojnë se operatorët e lokaleve dezinfektojnë lokalet;
- 3.3. në çdo hyrje të qendrës tregtare, të vërë aparat për të hetuar personat me temperaturë të ngritur;
- 3.4. t'u mundësojnë dezinfektimin e duarve personave në hyrje të qendrës tregtare dhe në pika të mjaftueshme në hapësirat e përbashkëta;
- 3.5. sipas mundësisë, t'u shpërndajë dorëza dhe maska personave që nuk kanë;
- 3.6. t'ua ndalojnë hyrjen në qendër tregtare personave që kanë temperaturë të ngritur, që nuk bartin dorëza dhe maska, që nuk pranojnë të dezinfektojnë duart, ose që nuk u binden masave të tjera; dhe
- 3.7. të inkurajojnë lokalet brenda qendrës tregtare që të shmangin pagesat me para të gatshme, duke nxitur klientët (përmes zbritjeve ose formave të tjera) që të kryejnë pagesat elektronikisht.
4. Nëse nuk ka operator të vetëm përgjegjës për qendrën tregtare, përgjegjësia u bie bashkërisht dhe veç e veç operatorëve të lokaleve brenda qendrës tregtare.
5. Operatori përgjegjës për lokalin brenda qendrës tregtare ose për lokalin e gastronomisë duhet të marrë këto masa:
 - 5.1. të sigurojë se nuk do të ketë tollovi në lokal, duke kufizuar numrin e njerëzve që hyjnë në qendër tregtare, duke shpërndarë turmat dhe duke marrë masa të tjera të nevojshme;
 - 5.2. të dezinfektojnë lokalin;
 - 5.3. t'u mundësojnë dezinfektimin e duarve personave në hyrje të lokalit dhe në pika të mjaftueshme brenda lokalit;
 - 5.4. t'ua ndalojnë hyrjen në lokal personave që nuk pranojnë të dezinfektojnë duart ose që nuk u binden masave të tjera; dhe
 - 5.5. të shmangë pagesat me para të gatshme, duke nxitur klientët (përmes zbritjeve ose formave të tjera) që të kryejnë pagesat elektronikisht.
6. Operatori përgjegjës për qendrën tregtare, lokalin brenda qendrës ose lokalin e gastronomisë duhet të marrë të gjitha masat që kërkohen me vendimet e Qeverisë, vendimet dhe urdhëresat e ministrive përgjegjëse dhe me rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike lidhur me luftimin dhe parandalimin e pandemisë COVID-19.
7. Operatori përgjegjës për lokalin e gastronomisë duhet të marrë të gjitha masat që kërkohen me udhëzuesin e Ministrisë së Shëndetësisë për gastronominë.
8. Inspektorët komunalë në bashkërendim me inspektorët e MEPTINIS-it do të mbiqëyrin zbatimin e kësaj urdhërese.



9. Mbeten në fuqi urdhëresat MEPTINIS 01/01-01/05, 01/07 dhe 01/08, për aq sa nuk janë ndryshuar nga kjo urdhëresë ose vendimet e Ministrisë së Shëndetësisë ose të organeve kompetente.
10. Kjo urdhëresë hyn në fuqi menjëherë.



Rozeta HAJDARI

Ministre në detyrë

U dërgohet:

- Zyrës së Kryeministrit
- Zëvendëskryeministrit
- të gjithë ministrave (ministrive)
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë
- Inspektoratit i Tregut
- Inspektoratit i Punës
- inspektorateve komunale
- Departamentit Ligjor
- Arkivit të Ministrisë

